REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.10.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:40 dhe mbaroi në orën 12:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[1]

Mbledhja plenare drejtohet nga z. Rusi, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së datës 13.10.2022 lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Kurushi fillimisht relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë;

c. Gjykata e rrethit gjyqësor Tropojë.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

II. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

B. Gjykatat e Apelit sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:

1. Gjykata e Apelit Gjirokastër;

2. Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve Redion Hysa dhe Nikoll Sherrniku. Trupi gjykues përbëhet nga znj. Ulliri dhe znj. Hysko. Gjyqtari z. Përdeda ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake; ndërsa z. Hajredinaj ka qenë gjyqtar i seancës paraprake.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: z. Aurel Arapi.

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti për shkaqe shëndetësore gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i cili gjithashtu ka pengesë për arsye se nuk është gjyqtar

për të mitur, z. Ded Miri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Alda Sadiku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 1 në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. Sokol Shehu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Arta Llazari dhe Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Arta Llazari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Ka pengesë gjyqtare Enkeleda Dalipi si gjyqtare e hetimit paraprak. Çështja gjykohet me trup gjykues me 3 (tre) gjyqtarë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, duke përfshirë në short edhe gjyqtarin e transferuar pranë asaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, konkretisht: znj. Merita Karaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Suada Kurti dhe Florin Demollari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në

relacion). Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari. Gjyqtarja znj. Shkreli ka qenë gjyqtare të hetimeve paraprake. Gjyqtarja znj. Beluli ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për miratim marrëveshje fajësie, të cilën ajo nuk e ka miratuar.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (duke marrë në konsideratë ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe numrin e gjyqtarëve në këtë gjykatë).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: znj. Suela Xhani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Dejvi Çelçima.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi 2 (dy) gjyqtarëve për gjykimin e çështjes së themelit. Trupi gjykues kryesohet nga Ersida Bajgora, ndërkohë që Esmealda Xhili ka qenë gjyqtare e seancës paraprake. Zonja Lika dhe zonja Nakaj kanë qenë gjyqtare të hetimit paraprak.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. Olkeda Liçe.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Sonila Hoxha dhe Erlanda Agaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion). Kërkohet plotësimi i trupit gjykues me 1 (një) gjyqtar, pasi çështjet gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë secila.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetarja i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht: znj. Elvana Çiçolli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe 2, gjyqtarja Nafije Hasko.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për çështjen e parë në relacion kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Kanë pengesë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Apelit Vlorë, gjyqtari Dritan Hasani dhe Sokol Pina, si edhe Fatri Islamaj i caktuar me vendim të KLGJ-së për shqyrtimin e kërkesës penale të kallëzuesit. Çështja konsiderohet si tepër urgjente pasi është prishur edhe është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë dhe e pandehura është në limite të afateve të paraburgimit.

Për çështjen e dytë kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ka pengesë ligjore gjyqtarja Miranda Andoni, për shkak të pjesëmarrjes në vendimin penal (çështje e lidhur) nr.141, datë 11.04.2019.

Për çështjen e tretë kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ka pengesë gjyqtari Arben Dosti, për shkak të pjesëmarrjes në vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë ku ai ka qenë gjyqtar në trupin gjykues.

Për çështjen e katërt kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve për gjykimin e çështjes së themelit. Ka pengesë ligjore gjyqtari Arben Dosti për shkak pjesëmarrje në vendimin objekt ankimi dhe gjyqtarja Irena Brahimi për shkak pjesëmarrje në vendimin me nr. 171, datë 23.01.2021.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjes me numër rendor 1 në tabelë të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, ndërsa për çështjet me numër rendor 2-4 në tabelë të jetë Gjykata e Apelit Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë me numër rendor 1 në tabelë të jetë 3 (tre), ndërsa për çështjet me numër rendor 2-4 numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: znj. Valdete Hoxha.

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari z. Fatri Islamaj për shkak të pengesë ligjore sepse ai gjykon procedimin e lidhur (parashtruar pak më lart në relacion).

Në shortimin e çështjeve të tjera me numër rendor 2-4, të mos përjashtohet zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht: znj. Arta Duka.

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti znj.Sonjela Voskopi, për shkak se është me leje të paralindjes sipas njoftimit të dërguar në KLGJ me shkresën e datës 09.09.2022.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ornela Naqellari (relatore), Edlira Petri dhe Lutfije Celami (anëtare).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Arta Duka.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Dritan Hasani dhe Arta Duka.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Dritan Hasani dhe Arta Duka.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë".

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. I pandehurit ka paraqitur një kërkesë me objekt "Shuarje mase sigurimi" gjatë gjykimit të themelit të çështjes. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtari Genti Dokollari dhe gjyqtarja Irena Brahimi, e cila është caktuar me vendimin nr.404, datë 30.09.2022 të Këshillit. Me vendimin e datës 30.09.2022 i është pranuar kërkesa për heqje dorë gjyqtarit z. Fuçia pasi ka shprehur mendim me vendimin nr.10, datë 03.11.2022. Nga zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë i është pranuar kërkesa për heqje dorë edhe gjyqtares znj. Gjuzi pasi ka kryer veprime të hetimit paraprak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Gjyqtarja znj. Bezati është shprehur gjatë fazës së hetimit paraprak. Seanca është planifikuar për t'u zhvilluar më datë 17 tetor. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet për gjykimin e masës së sigurimit, që njëkohësisht do të jetë edhe gjyqtar për të vijuar gjykimin e themelit të kësaj çështjeje penale, është një.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke përfshirë edhe gjyqtarin e caktuar në skemën e delegimit pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Gjyqtari i përzgjedhur për këtë çështje do të jetë anëtar i trupit gjykues të themelit të çështjes me të pandehur Romeo Oçe. Znj. Irena Brahimi është anëtare e trupit gjykues të kësaj çështjeje gjyqësore penale që po gjykohet në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Arben Dosti.

Me këtë relacion të fundit, Komisioni mbyll relacionet për ditën e sotshme.

Meqenëse çështjet janë të ezauruara, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor